



Titulli i projektit

Ndërtimi i Rrugës turistike Topojan-Kroi i Kuq-Tërshenë-Bicaj

Tipi i projektit

Infrastrukturë turistike

Vendndodhja e projektit

Komuna Topojan dhe Bicaj

Buxheti i paravlerësuar

200,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Turizmi është prioriteti kryesor i Strategjisë Rajonale të Zhvillimit të Qarkut Kukës dhe zona e Gjallicës është zona e dytë prioritare për zhvillimin e turizmit, pas Shishtavecit. Me anë të projekteve të aplikuara deri tani, janë prekur pothuajse të gjitha zonat turistike të rajonit. Ndër këto janë edhe bjeshkët e Gjallicës, të cilat nuk kanë akses në infrastrukturë të zhvilluar për të mundësuar eksplorimin e tyre.

Gjatë gjithë stinës së verës kjo zonë frekuentohet shumë nga banorët e komunave përreth, të cilët shfrytëzojnë pasuritë e shumta bimore dhe kurative. Gjithashtu, në këto zona ende të pashfrytëzuara është rritur mjaft edhe numri i turistëve të aventurës. Duke pasur parasysh se zona e Bicajve dhe e Topojanit kanë të njëjtat vlera përsa i përket atraksionit turistik, ka lindur domosdoshmëria e ndërtimit të një rruge që shkurton distancat, duke lidhur më mirë këto dy zona dhe duke mundësuar shfrytëzimin e kësaj kurore të larmishme në një kohë shumë më të shkurtër se ekzistuesja.

Qëllimi/et specifik të projektit

OS1: Të shkurtohet distanca dhe të lehtësohet arritshmëria më e madhe e vendeve turistike

OS2: Të nxitet ndërveprim dhe bashkëpunimi ndërkomunal

OS3: Të rritet numri i turistëve vendas dhe të huaj dhe të nxiten investimet në këto zona

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

R.1 Infrastrukturë turistike të ngritur në zonën e Gjallicës.

R.2 Distancë e shkurtuar dhe kosto e ulur e transportit për zonat përreth

R.3 Shfrytëzim racional i pasurive natyrore

R.4 Rritje e numrit të turistëve vendas dhe të huaj

# PROJEKTI 2



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

1. Hartimi i projektit teknik për ndërtimin e rrugës
2. Ndërtimi i rrugës (vepra arti, sinjalistikë rrugore, turistike, etj.)
3. Ndërtimi i kapaciteteve vendore për promovimin e turizmit

Projekti mendohet të zbatohet për një periudhë 2-vjeçare

## Maturimi i projektit

Mungon një studim i zonës dhe është e domosdoshme të kryhet një studim i tillë për llojin e ndërhyrjes, përfshi përcaktimin e shtigjeve turistike dhe sinjalistikës së nevojshme.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financuesit e projektit:

- Nuk ka ende burime të përcaktuara

Projekti do të zbatohet nga:

- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës.
- Këshilli i Qarkut Kukës
- Bashkia Kukës

## Kostot e projektit

- 1 Hartimi i projektit teknik për rrugën 10,000€
- 2 Ndërtimi i rrugës (vepra arti, sinjalistikë rrugore, turistike, etj.) 175,000€
- 3 Trajnim stafit të dy komunave për promovimin e vlerave turistike 5,000€
- 4 Promovimi i vlerave natyrore të zonës me anë të fletëpalosjeve, guideve, dokumentarëve, aktivitete etj. 10,000€